

L I G J
Nr.7742, datë 26.7.1993

**PËR NDRYSHIMIN E NENIT 213 TË KODIT TË PROCEDURËS CIVILE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 213 i Kodit të Procedurës Civile ndryshohet si vijon:

"Përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të dënojë:

1) Me gjobë deri në dy paga mujore:

"Nëpunësit e personave juridikë e fizikë, kur nuk zbatojnë urdhrin e përmbaruesit gjyqësor për të bërë ndalesën në pagën e debitorit dhe kur nuk njoftojnë largimin nga puna të debitorit".

2) Me gjobë nga 10 mijë lekë deri në 500 mijë lekë:

a) Personin e detyruar me vendim gjyqësor, i cili kryen të kundërtën e asaj që me vendim është detyruar ta bëjë.

b) Personin e detyruar me vendim gjyqësor, i cili nuk kryen veprimin që është detyruar ta kryejë vetëm ai.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim te kryetari i gjykatës së rrethit, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.622, datë 4.8.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.